7 pas. Por siç e thashë, domethënë, është pjesa e fundit e
8 pyetjeve të mia.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Avokatja e Viktimave, e keni ju fjalën.

11 ZNJ. PUES: [Përkthim] Në qoftë se është kështu, sugjerimi
12 im do të ishte që dëshmitari të kishte kohë që të bënte -- të
13 merrte pak frymë, të bënte pak pushim pastaj të mund të
14 bëheshin pjesët e tjera për aq kohë sa -- nuk është se kemi
15 nxituar. Është shumë në këtë pjesë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Faleminderit.

18 Nuk e di zonja Prokurore nëse keni ndonjë gjë për të
19 shtuar lidhur me këtë çështje apo jo.

20 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
21 Gjykatës. Edhe ne jemi dakord me këtë sugjerim, sepse në këtë
22 mënyrë gjatë pushimit mund të përqendrohemi në faktin në qoftë
23 se do nevojitet që të bëj pyetje të tjera shtesë apo jo.
24 Kështu që personalisht e mirëpres këtë sugjerim.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 32
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Faleminderit.

2 Atëherë do flas me Zyrën e Mbrojtjes së Dëshmitarit edhe
3 lidhur me përkthimin.

4 [Anëtarët e Trupit Gjykses dhe Sekretarja
5 këshillohen]

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
7 avokat, do t'i kërkoj dëshmitarit që të vendosë edhe njëherë
8 dëgjueset dhe ti mund të vazhdosh me pyetjet e mëtejshme, me
9 dhjetë minutat, me pyetjet që thatë.

10 Zoti dëshmitar, do të vazhdojmë edhe për 10 minuta të
11 tjera dhe pastaj do të bëjmë pushim. Në rregull për ty?

12 DËSHMITARI: Në rregull.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
14 avokat, fjala për ju.

15 Z. VON BONE: [Përkthim]

16 Py. Zoti dëshmitar, tani dua të flas për varrimin e
17 [REDAKTUAR] Është dita ku ai u varros në [REDAKTUAR] ruaj në
18 [REDAKTUAR]. Për këtë ditë e kam fjalën. Dhe atë ditë do ta
19 marr si ditë reference. Ti ke shkuar atje një ditë më përpara
20 se atë ditë të veçantë. Pyetja ime është: a i ke thënë ti
21 ndokujt që ke shkuar atje më përpara?

22 Pë. Jo.

23 Py. Ditën kur [REDAKTUAR] u dërgua në varrezat në
24 [REDAKTUAR], ishte e njëjta ditë që u zhvarros trupi i tij.

25 A ka qenë atë ditë -- atë ditën kur u zhvarros dhe që u

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 33
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 dërgua dhe u varros në [REDAKTUAR], ti ke qenë i pranishëm në
atë

2 kohë. A ke bërë ti ndonjë gjë ose a ke marrë pjesë më ndonjë
3 veprim sa i takon zhvarrosjes së trupit apo heqjes së dheut?

4 Pë. Nuk e kam të kjartë pyetjen, t'lutna,

5 Py. Në mënyrë që ta nxjerrin trupin nga dheu, pra duhet që të
6 gërmohet, të hiqet dheu në mënyrë që të arrihet te trupi. Ti
7 vetë a ke gërmuar dheun?

8 Pë. Po.

9 Py. Ke qenë ti i vetmi person që ka gërmuar dheun apo ka
10 pasur edhe persona të tjerë që e kanë bërë këtë punë?

11 Pë. Ka pas edhe të tjerë persona.

12 Py. Kush ishin këta personat e tjerë?

13 Pë. Ka qenë [REDAKTUAR] edhe
14 dy tri vetë po nuk më kujtohen saktë tash.

15 Py. Kur e nxorët trupin e [REDAKTUAR], ai kishte ndonjë teshë
16 tjetër, përveç teshave, ndonjë rrobë tjetër?

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Unë
18 nuk e kuptoj pyetjen.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po ta them unë, nuk po duket se
20 është ide e mirë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ju
22 lë të vazhdoni, por pyetja nuk është e qartë, njeriu vesh
23 rroba, tesha. Por e kuptoj se ç'do të thuash. Mbase mund ta
24 thuash ndryshe, mund të të jap një sugjerim.

25 Hiqi të lutem ato kufjet.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 34
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Ti mund ta thuash "a ishte i mbuluar me ndonjë gjë".

2 Z. VON BONE: [Përkthim] Dua të zbuloj -- të them në qoftë
3 se ka pasur ndonjë unazë, ndonjë zinxhir, ndonjë gjë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
5 të thuash kishte ndonjë xhevahir apo ndonjë send të çmuar.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, se ky do të përbënte problem.
7 Pikërisht këtë po përpiqet ta gjej duke bërë pyetje të
8 përgjithshme, pa e specifikuar atë gjënë të cilën dua që ai ta
9 thotë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
11 kuptoj, por mënyra si e bën pyetjen e ngatërron dëshmitarin.
12 Unë e kuptoj ku do të dalësh, por a kishte ndonjë unazë a
13 ndonjë varëse, a ndonjë gjë?

14 Vazhdoni ju lutem.

15 Duhet të vendosi kufjet një herë dëshmitari.

16 Z. VON BONE: [Përkthim]

17 Py. [REDAKTUAR] a kishte në atë kohë ndonjë unazë, a ndonjë
18 zinxhir, ndonjë gjë që ti e pe kur e nxorët trupin?

19 Pë. Jo, nuk ka pas, veç i mbulum me qebe.

20 Py. Do t'ju jap ca shembuj sepse kam parasysh që njerëzit
21 ndonjëherë mbajnë ndonjë zinxhir në qafë, ndonjë unazë në
22 gisht. Gjëra të tilla e kam fjalën.

23 Pë. Jo, nuk ka pas.

24 Py. E mban mend, a kishte orë [REDAKTUAR] në atë kohë?

25 Pë. Jo.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 35
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

- 1 Py. Nuk mban mend apo s'kishte?
- 2 Pë. Nuk e mbaj mend.
- 3 Py. Faleminderit. A të kujtohet, a kishte ndonjë person që
- 4 bënte fotografi në atë çast?
- 5 Pë. [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 Py. E njeh atë person? Ose e njohje?
- 8 Pë. Po, e njoh.
- 9 Py. Si erdhi ai person aty?
- 10 Pë. [REDAKTUAR] e ka lajmru OSBE-në në atë kohë. Ata e kanë
- 11 dërguar atë.
- 12 Py. A e di ti sa foto bëri personi?
- 13 Pë. Jo, nuk e di.
- 14 Py. Fotografi ishte burrë apo grua për të cilën po flasim?
- 15 Pë. [REDAKTUAR]
- 16 Py. E di ti sa fotografi bëri ajo?
- 17 Pë. Jo, nuk e di.
- 18 Py. I pe ti ato fotografitë ndonjë herë?
- 19 Pë. Kurrë s'i kam pa.
- 20 Py. Kur e nxorët nga varri trupin, në atë kohë ti a i pe
- 21 ndonjë shenjë, ndonjë lëndim në trup [REDAKTUAR]?
- 22 Pë. Po, i kam pa.
- 23 Py. Në ç'pjesë të trupit ja ke parë?
- 24 Pë. I ka pas dy këmbët e thyme, dy duart e thyme, mbrapa
- 25 shpinës ka pas birat të plumbave.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Faqe 36

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Dhe ku mbas shpine i kishte këto vrimat?

2 Pë. Në anë të kraharorëve.

3 Py. E ke fjalën që vrimat ishin në shpinë, por në lartësinë e
4 kraharorit apo në kraharor?

5 Pë. Jo, mbrapa shpinës, në kraharor. Jo në krah, po kah pjesa
6 e mushkërive.

7 Py. Po si ja pe ti ato?

8 Pë. Se e kam rrotullu, me e kqyr.

9 Py. A i pe lëndime të tilla në vende të tjera të trupit?

10 Pë. [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR] më falni.

12 Py. Ku në ç'vend i kishte?

13 Pë. Ma poshtë se gjuri.

14 Py. Por, në kokë, a kishte ndonjë shenjë? Në kokë, në sy apo
15 në dhëmbë?

16 Pë. Jo, nuk më kujtohet.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam edhe nja
18 dy pyetje të fundit.

19 Py. Ke punuar ti ndonjëherë [REDAKTUAR]?

20 Pë. Po.

21 Py. Ke folur ndonjëherë me [REDAKTUAR] për atë që i ndodhi
22 [REDAKTUAR]?

23 Pë. Po. Në vitet 2000 kam fol, veç e kam pyet çka ka ndodh.
24 [REDAKTUAR] m'u ka përgjigj: "Urdhën e kam pas".

25 Py. A të tregoi se nga e kishte marrë këtë urdhër?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 37
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Jo.

2 Py. Po ti e besove?

3 Pë. Po.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi pyetjet të tjera.

5 Faleminderit shumë, zoti dëshmitar.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit, avokati i Mbrojtjes.

8 Të kalojmë tani në seancë publike, ju lutem.

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Zoti dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim dhe
14 sekretarja do të të nxjerri nga salla e gjyqit dhe do të
15 takohemi përsëri në orën 12.00, pra do të bëjmë një pushim pak
16 më të gjatë me qëllim që të kesh mundësi që të pushosh pak.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

19 shoh që jeni ngritur në këmbë, avokat.

20 Do të ndërpresim tani punën dhe do të rishihemi në orën

21 12.00.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

23 --- Pauza fillon në orën 11.11

24 --- Seanca rifillon në orën 11.59

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pari përbërjen e palëve. Shoh që ZPS-ja ka të njëjtën
2 përbërje.

3 Znj. Prokurore.

4 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po jemi të njëjtët si më parë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit.

7 Avokate e Viktimave besoj që kjo vlen dhe për ju.

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Dhe ne jemi të njëjtët.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Dhe Avokati i
10 Mbrojtjes shohim që keni të njëjtin ekip.

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, nuk kemi ndryshim.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
13 z. Mustafa është i lidhur nëpërmjet videolidhjes. Na dëgjoni
14 mirë z. Mustafa.

15 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
17 mirë. Lidhur me vazhdimin e punës sot dhe nesër në vartësi -
18 jo së pari do bëj një pyetje tjetër.

19 Sipas rregullave dhe vendimit tonë për ecurinë e
20 procedurave mund të lejojmë pyetje shtesë n.q.s. është e
21 nevojshme.

22 Znj. Prokurore keni nevojë? Dëshironi të vazhdoni me
23 pyetjet shtesë?

24 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo, nuk kemi pyetje shtesë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit.

2 Ju Avokate e Viktimave?

3 ZNJ. PUES: [Përkthim] As ne nuk do të bëjmë pyetje të
4 tjera.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
6 Atëherë vetëm ne Trupi Gjykses kemi mbetur për t'i bërë pyetje
7 Dëshmitarit.

8 Do të vazhdojmë me këtë dëshmitar dhe sigurisht do ta
9 përfundojmë dëshminë e tij dhe do të doja ta përfundonim
10 përpara dreke meqë nuk ka pyetje shtesë po kundërpërgjigje,
11 besoj që mbase mund të mbaroj pak më vonë se ora 1.00. Por
12 gjithsesi kryesorja është që ta mbarojmë përpara dreke. Në
13 rregull.

14 Sekretare, të lutem silleni brenda dëshmitarin.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
17 se ke ardhur përsëri, z. dëshmitar.

18 DËSHMITARI: [E padëgjueshme]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti
20 dëshmitar, të kanë bërë disa pyetje Prokuroria dhe Mbrojtja
21 dhe nga Avokatja e Viktimave. Duro dhe pak të lutem sepse dhe
22 ne si Trupit Gjykses dëshirojmë t'ju bëjmë disa pyetje të
23 tjera. Në këtë mënyrë do të jemi më të qartë lidhur me
24 dëshminë që ti ke dhënë këtu.

25 Pyetje nga Trupi Gjykses:

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 40
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra
2 zoti dëshmitar, pyetja e parë që kam për ty është kjo. Dje në
3 transkript për procesverbal është rreshti 5 deri në 10, 1775
4 [sipas përkthimit], ti the që të nesërmen pasi erdhën ata
5 ushtarët e UÇK-së që kërkonin [REDAKTUAR], ti pastaj shkove të
6 kërkoje [REDAKTUAR]. Pyetje që kam unë është kjo -

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
9 kalojmë në seancë private ju lutem.

10 [~~Seancë private~~][Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Për procesverbal po e përsëris që dje ti the se shkove të
15 kërkoje [REDAKTUAR] një ditë pasi dëgjove se tre ushtarët e
16 UÇK-së e kishin marrë me vete.

17 Pyetja që kam për ty është kjo: Pse pate frikë se diçka
18 mund t'i kish ndodhur [REDAKTUAR]?

19 Pë. Ma ka ndi zemra që ka me ndodhë diçka mbasi na kanë
20 pyetur lidhur me të.

21 Py. Dhe kjo ndjesi që pate, që ta ka ndi zemra, ku e
22 mbështete ti këtë, a mund të na thuash? Pse e pate këtë
23 ndjesi?

24 Pë. Veç ma ka lidh truni me çfarë arsye kërkojnë.

25 Py. Dhe kjo kishte lidhje me personat që e morën?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 41
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Po.

2 Py. Që të jem më konkrete, janë fjalët e mia që po e them,
3 sepse këta personat ishin ushtarë të UÇK-së?

4 Pë. Po.

5 Py. A mund të na e shpjegosh se përse pate frikë në atë kohë
6 nga këta ushtarët e UÇK-së? Në rrethanat konkrete, nuk e kam
7 fjalën në përgjithësi, po në rastin konkret.

8 Pë. Jo, veç kam deshtë me shku te [REDAKTUAR] me u konsultu
9 me të pse të kanë kërku.

10 Py. Po pse ke ndier frikë? Prit ta them ndryshe - a kishe
11 mësuar ti se mënyra sesi e kishin marrë e kishin marrë me
12 forcë apo me dhunë, kjo ishte arsyeja që ti pate ide se diçka
13 mund t'i kishte ndodhur?

14 Pë. Po.

15 Py. Kush ta dha këtë informacion?

16 Pë. Për rrëmbimin e tij?

17 Py. Po, n.q.s. të kuptova drejt, mendova se the që mendove se
18 të thanë që e kishin marrë me dhunë, me forcë, kështu ka qenë?

19 Pë. Po.

20 Py. Po si ta treguan sesi kish ndodhur ky rrëmbimi?

21 Pë. Rrëfimin ma ka tregu [REDAKTUAR], emri i [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Çfarë
24 të tha tamam n.q.s. mund të na thuash?

25 Pë. Se [REDAKTUAR] e morën [REDAKTUAR] me dy ushtarë të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 42
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 tjerë, e kanë shti në kerr.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Po [REDAKTUAR]

3 të tha ndonjë gjë për të ndjerin [REDAKTUAR] që u fut me
4 pahir, me

5 zorr si të thuash, jo me dëshirën e vet në këtë veturë?

6 Pë. Po, e ka pyetur [REDAKTUAR], arsyeja pse po e merrni?

7 Kena me ja bo një intervistë.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A të

9 tha gjë [REDAKTUAR] se [REDAKTUAR] nuk kishte dëshirë me shku

10 në atë veturë?

11 Pë. Jo, nuk ka pasë dëshirë me shku.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit. Dua që tani të flasim për atë ahurin. Dje na the

14 në faqen 17 [sipas përkthimit], është shkruajtur ke rreshti 6

15 deri në 8 të transkriptit, faqja 1747, rreshtat 23 deri në 25.

16 Pyetja e parë që kam për ty është kjo: Si e gjete këtë

17 ahurin që the se e mbanin të burgosur [REDAKTUAR]?

18 Pë. Duke kërkuar me [REDAKTUAR].

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

20 mund të na shpjegosh pak më shumë për këtë kërkimin që bëtë me

21 [REDAKTUAR]?

22 Pë. Po, në atë arrë e kam gjetë letërnjoftimin e të ndjerit.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

24 ishte pyetja ime kjo. Pyetja që të bëra është - mbase s'isha e

25 qartë - si e mësove ti se - pse shkove te ai ahur dhe jo në

26 një ahur tjetër pra?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 43
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Kena kërku nëpër shumë shtëpia deri aty.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
3 kuptoj. Pra që të them me fjalët e mia dhe më korrigjo po ta
4 kem gabim, ju shkuat në shumë shtëpi dhe shikonit, kërkonit
5 gjithandej për të gjetur ndonjë, diçka që [REDAKTUAR] kishte
6 qenë aty për shembull, këtë po thua - para se të shkosh në
7 fund?

8 Pë. Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
10 kuptoj, e kuptoj, në rregull. A mund të na i shpjegosh atë
11 ahurin për të cilin na fole? A mund të na i përshkruash?

12 Pë. Ka qenë 20-30 metra ma larg se shtabi i UÇK-së.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, a
14 mund të na i përshkruash vetë sesi ishte brenda ky ahuri, jo
15 largësinë, jo distancën, po dua të di sesi ishte ky ahuri
16 brenda?

17 Pë. Lart ka qenë shpi banimi, bodrumi ka qenë ahër.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po te
19 shtëpia lart ke shkuar?

20 Pë. Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si u
22 futët në shtëpi?

23 Pë. Shpia lart, kati i dytë ka qenë i prishur.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Hmm-
25 hm.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 44
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Në bodrum, në ahër.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ja
3 një minutë sa të firmos diçka këtu sepse nuk u futëm në seancë
4 private që t'i heqim nga ato që thamë përpara që mos t'i marri
5 vesh publiku dhe nga transkripti i procedurës këtu.

6 Pra kati i sipërm, the që ishte i shkatërruar. Por për
7 t'u futur brenda në shtëpi, si u futët brenda?

8 Pë. Ka qenë i prishur. Në anën tjetër e ka pasë ahri derën.
9 Aty jena hi, kena pa, ka pasë disa qebe, batanije.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
11 për të shku tek kati i sipërm mbi bodrum se ti the që shkuat
12 lart e kuptova drejtë?

13 Pë. Jo, jo, ka qenë dy kate.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ti
15 a shkust a nuk shkust lart ke pjesa e banesës?

16 Pë. I kalbt. Kati i dytë ka qenë ku ka vendbanim ka qenë i
17 kalbt, i djegun. Bodrumi ka qenë ahër.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po
19 kulmi, çatia a ishte akoma aty?

20 Pë. Edhe nuk më kujtohet saktësisht.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Në rregull. Kjo
22 ndërtesë ku ndodhej? Ja të mbaroj.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Sekretare të lutem paraqisni deklaratën e dëshmitarit, 077828-
25 TR-ET, e rishikuar, Pjesa 2, në faqen 5.

1 A mund të na shpjegosh se sa larg ishte ahuri nga vendi
2 ku më vonë gjetët të varrosur [REDAKTUAR]?

3 Pë. Ka qenë, ahuri ka qenë në distancë prej varrit 300-400
4 metra. Tash s'muj e përshkruaj 300-400 veç q'kët largësi ka
5 qenë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ky
7 ahuri ku ndodhej? Ishte poshtë a lart apo në një livadh a ku
8 ndodhej?

9 Pë. Afër ku ish ish-shtabi i UÇK-së.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
11 kuptoj. Tani dua që të të tregoj rreshtin 22 të deklaratës që
12 ke dhënë. Ja një minutë. Jo nuk është ky që duhet.

13 Do kërkoj diçka se nuk më duket se është ajo që duhet.
14 Po, ja këtë kërkoja që doli tani në ekran.

15 Këtu ke thënë që:

16 "Varri ishte në një lëndinë më poshtë, kurse shtëpia
17 ishte pak më e ngritur si terren".

18 A të kujtohet?

19 Pë. Po.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
21 mirë. Tani do - faleminderit Sekretare. Kaq mjaftonte për sa
22 i takon dokumentit.

23 Kemi diskutuar sot në mëngjes por edhe dje çështje që për
24 ty e kuptoj janë mjaft të ndjeshme. Diskutua se kur e nxorët
25 trupin e [REDAKTUAR], patë që i kishte këmbët dhe duart të

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 46
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 thyera dhe këto janë shkruar në faqen 1745, rreshtat 3 deri në
2 4, rreshtat 23.

3 Përpara se të shkonit tek vendi ku ishte varros
4 [REDAKTUAR], a ju kishte thënë njeri që këmbët dhe duart i
5 kishte të thyera, e dinit këtë gjë ndërkohë ju?

6 Pë. Mu personalisht jo. Edhe nuk më kujtohet, 22 vite.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do
8 t'i kërkoj Sekretares që të na shfaqë dokumentin, deklaratën
9 me numër identifikimi 077828-TR-ET, 24 gusht 2020, Pjesa 1,
10 faqja 8. Shkojmë tek rreshti 21.

11 Këtu ju thoni që "një ushtar i UÇK-së, [REDAKTUAR] i
12 cili jeton në [REDAKTUAR] tha që, duart dhe këmbët e
13 [REDAKTUAR] ishin të thyera gjatë mbajtjes së tij të ndaluar".

14 A e konfirmoni këtë gjë që ka ndodhur kjo që sapo lexova?

15 Pë. Kjo është që i ka thënë [REDAKTUAR]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 rregull, po këtu thuhet që ju e keni dëgjuar nga një ushtar i
18 UÇK-së. Po tani po thua që nuk ke dashur të thuash këtë gjë,
19 por që do të thuash që ushtarët e UÇK-së i thanë [REDAKTUAR]
20 jo ty, këtë po thua?

21 Pë. [REDAKTUAR] i ka thënë, jo mu. Edhe, më fal, nuk më
22 kujtohet krejt.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
24 Sigurisht që nuk është problem kjo. Ti jep dëshminë mbështetur
25 në atë çfarë mbani mend. Ne përpiqemi që të qartësojmë atë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 47
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 çfarë keni thënë më përpara në mënyrë që të përpiqemi që të
2 mos kemi keqkuptime.

3 [REDAKTUAR] a tha ty këtë gjë, d.m.th. çfarë i kishte
4 thënë atij [REDAKTUAR]?

5 Pë. Nuk më kujtohet.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk
7 të kujtohet, po këtë e keni deklaruar për ZPS-në, për
8 Prokurorinë. Pra Prokurorisë i keni thënë që "E kam marrë vesh
9 këtë gjë, e kam dëgjuar këtë nga një ushtar". Tani po thoni që
10 "Kjo i është thënë [REDAKTUAR], jo ty". Pyetja tjetër që kam
11 për ju është kjo: A e mban mend se kur ta ka thënë [REDAKTUAR]
12 këtë gjë? Sepse n.q.s. nuk e mban mend si do ta dinit që ka
13 ndodhur kjo?

14 Pë. Po, ka mundësi që edhe kam harru. Ndoshta më ka thënë po
15 edhe kom harru.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
17 qoftë ke harruar nuk do të pyes se kur. Në rregull.

18 Ti the dje në transkript dhe e kam fjalën këtu për faqen
19 7475 [sipas përkthimit], rreshti 10 dhe 11, që z. [REDAKTUAR]
20 qëndroi për dy-tre ditë në [REDAKTUAR]. A ju tregoi se
21 çfarë i kishte ndodhur [REDAKTUAR] kur kishte qenë i ndaluar?

22 Pë. Po, na ka tregu.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
24 mund të na thuash se çfarë ju tha ai?

25 Pë. Na ka tregu se e kanë rreh, e kanë maltrajtu shumë dhe ja

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 48
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kanë thyer këmbë e duar. Për atë arsye nuk e kanë liru.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ju

3 tregoi juve ai se çfarë i kishte ndodhur vetë [REDAKTUAR]?

4 A ju tha se çfarë i kishte ndodhur atij vetë?

5 Pë. Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

7 mund t'i tregoni Trupit Gjykses se çfarë ju tha ai?

8 Pë. Tregojke qysh e kanë rreh UÇK-ja.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ju

10 tha, ju tregoi ai ju se kush e kishte rrahur?

11 Pë. Jo me emër. Nuk më kujtohen emrat.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: Znj. Sekretare,

13 a mund të shfaqni dokumentin me numër reference 060723-TR-ET,

14 e rishikuar, Pjesa 1, faqja 38, rreshtat 12 dhe 13.

15 Këtu i thoni Zyrës së Prokurorit të Specializuar, "a

16 përshkroi [REDAKTUAR] se çfarë i kishte ndodhur vetë atij?",

17 Përgjigjja që jepni është "po".

18 Ndërsa pyetja tjetër është: "A e mbani mend se çfarë ju

19 tregoi ai"?

20 Përgjigje: "Ti thua që ai shpjegoi të njëjtën situatë

21 sesi [REDAKTUAR] e kishte rrahur dhe çfarë i kishin bërë atij,

22 çdo gjë. Gjithçka."

23 Pyetja ime është kjo: A ju tha ai se ishte rrahur nga

24 [REDAKTUAR] edhe kush është [REDAKTUAR], d.m.th. si e ka

25 mbiemrin [REDAKTUAR]?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 49
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Po, [REDAKTUAR] e ka emrin, mbiemrin [REDAKTUAR].

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 [REDAKTUAR] a ju tregoi diçka më tepër sa i takon

4 rolit të [REDAKTUAR]?

5 Pë. Nuk më kujtohet. Kam harru.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Faleminderit. Tani kam një pyetje rreth gruas - ose do ta them

8 ndryshe. A e di ti nëse [REDAKTUAR] jetonte - në kohën

9 që po diskutojmë në 1997-1998, në 1999 a jetonte me një grua,

10 a bashkëjetonte me një grua [REDAKTUAR]

11 Pë. Unë nuk e di.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Domethënë nuk e dini në qoftë se kishte ndonjë partner

14 [REDAKTUAR] në atë kohë?

15 Pë. Nuk e di.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

17 [REDAKTUAR] a kishte probleme me ndokënd që mund të

18 çonte në hakmarrje? Probleme që mund të çonin në hakmarrje?

19 Pë. Nuk e di.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A të

21 kujtohet ty nëse ka pasë një kohë të caktuar kur ke dëgjuar

22 për vdekjen e mundshme të [REDAKTUAR] përpara sesa të gjenit

23 varrin.

24 Pë. Jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391(Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 50
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kërkoj Sekretares që të na shfaqë deklaratën që keni dhënë ju,
2 që është dokumenti me numër referimi 077828-TR-ET, Pjesa 1,
3 faqja 7, rreshtat nga 6 deri në 10.

4 Këtu thoni që:

5 "Më pas kur filloi ofensiva serbe njerëzit nga kampi i
6 UÇK-së në Zllash ikën dhe [REDAKTUAR] erdhi së bashku me
7 ushtarët në [REDAKTUAR]. Unë e takova atë dhe e pyeta rreth
8 [REDAKTUAR] sepse dëgjova ca thashetheme që ai ishte i
9 vdekur..." Por ai nuk më dha asnjë informacion.

10 Këtu thoni që kishit dëgjuar ca thashetheme. Dua të di në
11 qoftë se ju kujtohet ndonjë gjë pasi dëgjuam këtë paragraf. A
12 ju kujtohet se nga i keni dëgjuar këta thashetheme?

13 Pë. Po, tash më kujtohet. Po.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
15 mban mend kur i ke dëgjuar këto?

16 Këto thashethemet, kur i ke dëgjuar?

17 Pë. Mbasi që kanë ardhur UÇK-janë në fshatin [REDAKTUAR].

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A
19 mund ta caktosh kohën? Mund të na thuash kur?

20 Pë. Nuk muj se kam harru.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje
22 ne pamë certifikatën e vdekjes të [REDAKTUAR]. Kjo
23 reflektohet në faqen e transkriptit 1763, rreshti 10. Data që
24 mban kjo certifikatë vdekje është data [REDAKTUAR].

25 A e di ti se kush e ka dhënë këtë datë ose kush e ka

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Page 51
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vendosur këtë datë? Kush e ka dhënë këtë datë për

2 certifikatën?

3 Pë. Jo nuk e di. [REDAKTUAR] u shku për me shly, po unë nuk e
di.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra
5 pyetja ime është, a e di? Ti thua "nuk e di". Por a e di ti se
6 pse është zgjedhur kjo datë për certifikatën e vdekjes?

7 Pë. Nuk e di.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje
9 në transkript, në faqen 1747, rreshti 22, juve ju bë pyetja
10 sesi [REDAKTUAR] e gjeti varrin e [REDAKTUAR]. Nuk është se e
11 shoh vërtet përgjigjen e kësaj pyetjeje. Ti na the shumë gjëra
12 por nuk e shoh përgjigjen e kësaj pyetjeje, kështu që prandaj
13 dua ta bëj edhe njëherë pyetjen.

14 Si e mori vesh [REDAKTUAR] se ku ishte varri?

15 Pë. Unë jam deklaruar edhe dje dhe prapë e them, ka mundësi që
16 [REDAKTUAR] i ka tregu dikush ku o varri, po për shkak të
17 sigurisë tonë edhe të vetën edhe të personave që ja kanë
18 tregu, [REDAKTUAR] neve na ka thonë, e kam pa në ëndërr.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
20 Sekretare, ju lutem a mund të shfaqni dokumentin që mban
21 numrin e referencës 060723-TR-ET, Pjesa 2, rreshti nga 2 deri
22 në 14.

23 Kemi dy persona që jepen me emër, [REDAKTUAR]
24 [REDAKTUAR]. A e di ti se çfarë i thanë ata [REDAKTUAR] lidhur
25 me çështjen e [REDAKTUAR]?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 52
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Nuk më kujtohet edhe kam harru.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ti
3 thua në dëshminë që i ke dhënë Prokurorisë që:

4 "Ata i treguan [REDAKTUAR] tim, i treguan [REDAKTUAR] tim
5 rreth çështjes së [REDAKTUAR] por publikisht nuk kanë guxuar
6 asnjëherë të thonë asgjë."

7 A e di ti sepse kishin frikë ata?

8 Pë. Kanë pasë frikë prej UÇK-së mos me treguar.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Ndoshta po përsëris veten, po çfarë nuk donin të thonin ata?

11 Pë. Ku është varri, që i kanë tregu [REDAKTUAR] ku është
12 varri. Për

13 atë arsye dhe neve [REDAKTUAR] nuk na ka tregu hollësitë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Faleminderit. U bënë disa pyetje sa i takon zhvarrimit të
16 [REDAKTUAR]. I dëgjua dhe nga Prokuroria. Edhe lidhur me këtë
17 çështje kam dy pyetje, pyetja e parë është kjo: Kur është
18 varros trupi i [REDAKTUAR], a pe ti në qoftë se
19 duart i kishte të lidhura?

20 Pë. Jo, nuk i ka pasë duart e lidhme.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] UÇK-
22 së diskutua dhe sot paradite, por sa për ta sqaruar më mirë,
23 sa herë ke qenë ti te vendi ku është varrosur [REDAKTUAR]
24 herën e parë?

25 Pë. Dy herë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 53
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 këqyre ti trupin e tij herën e parë që shkove atje?

2 Pë. Jo, herën e parë nuk e kena këqyr, veç e kena identifiku
3 që është [REDAKTUAR] edhe e kena mshel.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Faleminderit. Në transkriptin e ditës së djeshme, faqja 1749,
6 rreshti 22, ti the që e njohe [REDAKTUAR] nga
7 [REDAKTUAR] që kishte.

8 Dua t'ju pyes - pyetja që kam për juve është: Ky
9 [REDAKTUAR] ishte [REDAKTUAR] apo jo?

10 Pë. Por [REDAKTUAR].

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot
12 paradite në transkript që është transkripti në kohë reale, jo
13 faqe zyrtare, por në këtë transkript në faqen 35, rreshti 7,
14 ti na the ne që ke punuar [REDAKTUAR].

15 Pyetja që kam për ty është kjo: Si e gjete këtë vendin e
16 punës në [REDAKTUAR]?

17 Pë. Jam punësuar në vitin 1995.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po si
19 e more atë vend pune? Pe ndonjë njoftim diku për një vend të
20 lirë pune, dëgjove nga dikush, si ndodhi që e more atë vend
21 pune?

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR]

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Page 54
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Faleminderit për shpjegimin.

11 Zonja Sekretare, a mund të na shfaqni në ekran deklaratën
12 077 060723-TR-ET, Pjesa 2, faqja 24, rreshtat nga 4 deri në 8.

13 Jo këtë, nuk është kjo deklarata e duhur. Duhet të jetë
14 deklarata e datës 6 qershor 2019.

15 Ju kërkohet ndjesë zoti dëshmitar. Dua që të gjej
16 dokumentin e duhur dhe m'u krijua përshtypja që nuk është
17 dokumenti i duhur. Të kërkoj ndjesë.

18 Pë. Në rregull.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit.

21 Do ta kaloj për momentin se nuk dua që të na presësh.

22 A e njoftove ti rastin e [REDAKTUAR] te UNMIK-

23 u?

24 Pë. Unë jo, [REDAKTUAR] e ka njoftue.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 55
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR] a e dinte që ju e njoftuat çështjen UNMIK-ut?

2 Pë. Po, e ka ditë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
4 nga e dije ti që ai e ka ditë?

5 Pë. Sa herë kam dhënë deklaratë në UNMIK, [REDAKTUAR] kur më
6 ka taku, më ka thonë, "Kot e keni. S'keni çka më bani".

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
8 Faleminderit. A je ndjerë ti i kërcënuar?

9 Pë. Me fjalë po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dje
11 në transkript, faqja 1764, rreshtat 4 dhe 5, ti fole rreth
12 frikës dhe stresit me të cilin jetoni edhe sot e kësaj dite.
13 Për çfarë keni frikë më së shumti?

14 Pë. Veç kena frikë mos po na ndodhë diçka si do dëshmitarëve,
15 mos po na kërcënon dikush mu ose [REDAKTUAR].

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga
17 kush keni frikë?

18 Pë. Nga këta të akuzuarit.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
20 në qoftë se thua nga "të akuzuarit" a mund të jesh më konkret?

21 Mund të të ndihmoj për shembull, që mund të jenë ndoshta
22 të akuzuar në çështje të tjera përpara Gjykatës?

23 Pë. Dikush shembull prej shokëve të [REDAKTUAR], ose e shtin
24 dikënd me na kërcënu ose diçka.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Faqe 56
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 përmende fjalën "të akuzuarit". Çfarë do të thuash me "të
2 akuzuarit"? Për kë e ke fjalën?

3 Pë. Po unë e kam akuzu për shembull [REDAKTUAR] ose si është
4 rasti Salih Mustafës.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do ta
6 bëj pyetjen për të qenë më e qartë. A ke frikë ti nga i
7 akuzuari në këtë çështje, ke frikë nga z. Mustafa?

8 Pë. Po.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit për këtë. Do ta lëmë këtë pikë dhe tani kam marrë
11 një referencë të mundshme të dokumentit që po diskutonim pak
12 më përpara.

13 Do t'i kërkoj Sekretares që të na e shfaqë në ekran për
14 të kontrolluar n.q.s. ky është dokumenti. Është dokumenti me
15 numër reference 060723-TR-ET, faqja 23, rreshtat 3 dhe 4.

16 Sa për t'u sqaruar vetë, ti ke punuar me [REDAKTUAR] në
17 [REDAKTUAR], kështu?

18 Pë. Po, unë jam konë [REDAKTUAR].

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
20 kuptoj. Këtë desha të konfirmoja.

21 A ka ndonjë gjë që dëshiron t'ia thuash Trupit Gjykses të
22 cilën ne nuk e kemi diskutuar ende?

23 Pë. Jo.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të
25 lutem, më thuaj nëse do.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari:W04391 (Vijon) (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493
Pyetje nga Trupi Gjykses Page 57
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Nuk po di.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Atëherë do të pyes kolegët nëse kanë pyetje të tjera.

4 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

6 rregull.

7 Zoti dëshmitar, faleminderit shumë. Kemi ardhur në fund
8 të dëshmisë tënde dhe e shoh, e kuptoj që ka qenë shumë e
9 vështirë për ty. Dëshiroj të të falënderoj për përpjekjen që
10 ke bërë për të dhënë këtë dëshmi, sepse besoj që na ke
11 ndihmuar shumë si Trup Gjykses për t'u përpjekur të gjejmë atë
12 që ka ndodhur në atë kohë. Faleminderit shumë.

13 DËSHMITARI: Ju faleminderit edhe juve.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja
15 Sekretare, të kalojmë në seancë publike të lutem.

16 [Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E
19 shoh që është - se është shumë e vështirë për ty dhe të
20 falënderoj për përpjekjen që ke bërë për të dhënë dëshminë.
21 Uroj kthim të shëndoshë në shtëpi.

22 Rrugë të mbarë pra dhe dëshiroj që të mos e diskutosh me
23 askënd këtë që ke dhënë këtu.

24 Tani Sekretarja do të të nxjerrë jashtë nga salla e
25 gjyqit dhe njëherë të falënderoj për dëshminë e dhënë.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbaruam me dëshminë e Dëshmitarit W04391. Keni ndonjë gjë
4 zonja Prokurore që dëshironi ta ngrini në këtë moment?

5 ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Jo.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju,
7 Avokate e Viktimave?

8 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo, as ne nuk kemi gjë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe
10 Avokati i Mbrojtjes?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] Asgjë nuk kemi e nderuar
12 Gjykatëse.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
14 nuk ka gjë tjetër për sot, do të rifillojmë nesër me dëshminë
15 e dëshmitarit W04390.

16 I falënderoj palët për praninë, si gjithmonë përkthyesit,
17 stenografin, sigurinë, të gjithë teknikët.

18 Atëherë takohemi nesër në orën 9.30.

19 --- Seanca përfundon në orën 12.56.

20

21

22

23

24

25